Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Zeka	**17.07.2023**	**21.07.2023**	**2023/0476**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 10.07.2023, OE **"VIA EGNATIA SH.P.K."-** Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0476, kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit**: "Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve"** me nr. të prokurimit: **"615-23-4993-2-1-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E PODUJEVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: kontratë kornizë me një Operator Ekonomik, shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: **650,000.00 €**.

Fazat e procedurës se prokurimit:

Njoftimi për kontratë.....22.05.2023;

Përgjigje ne kërkesën për sqarime.....09.06.2023

Përgjigje ne kërkesën për sqarime.....15.06.2023

Kërkesa për rishqyrtim 27.06.2023;

Vendimi i AK-se ne kërkesë për rishqyrtim.....30.06.2023;

Ankesa ne OSHP.....10.07.2023;

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure ka shkelur këto dispozita:

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe nenin 17 të RRPP-001/2022

AK ka shkelur nenin 51 të LPP-së , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së , i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-se pasi që gjate hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kritereve dhe kërkesave për OE, ka vendosur kritere kufizuese të cilat qartë shihet se ia ka përshtatur një OE të caktuar. Po ashtu ka vendosur kritere shumë diskriminuese dhe kufizime të panevojshme që shumicës së OE ia pamundësojnë pjesëmarrjen në këtë tender. Ky veprim i AK-së bie ndesh me nenin 7 të LPP-së si dhe bie ndesh edhe me nenin 27, 51 dhe 69 të LPP-së që flasin për procedurat e prokurimit për shërbime sepse ka bërë favorizim të OE të caktuar që pretendon edhe të ua jap kontratën padrejtësisht. Krejt kjo konsiderohet favorizim i OE dhe njëkohësisht edhe diskriminim i të tjerëve e që bie plotësisht ndesh me nenin 7 të LPP-së. Përpos kësaj ka lënë shumë elemente pa i përcaktuar saktë tek kërkesat për OE të cilat lënë vend për manipulim gjatë procesit vlerësimit të tenderuesve dhe rrezikojnë AK-në që të bëjë shpenzim të dëmshëm të buxhetit të Komunës.

Pikat dhe kriteret kufizuese si dhe gabimet e mëdha që ndodhen në dokumentet e tenderit, do ti përshkruajmë tek pretendimet tjera që lidhen drejt për drejt edhe me nenet e LPP-së dhe RRPP-001/2022 që janë shkelur.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 pasi që gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht gjatë hartimit të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, ka vendosur shumë kritere kufizuese e në të njëjtën kohë ka lënë kritere pa i vendosur që janë të domosdoshme për natyrën e projektit. Bazuar në këtë del që dosja e tenderit nuk është hartuar në përputhje me nenin 27 të LPP-së përkatësisht me nenin 17 të RRPP-001/2022. Ja si e përshkruan obligimin e AK-së në hartim të dokumenteve të tilla neni 17 i RRPP-001/2022.

Rregullorja kërkon nga AK që:

Ndërsa nenin 25 i po të njëjtës rregullore kërkon nga AK që:

AK nuk e ka respektuar këtë andaj konstatojmë se gjatë hartimit të dosjes së tenderit janë shkelur parimet bazë të prokurimit, është shkelur neni 27 i LPP-së si dhe është shkelur neni 17 dhe 25 i RRPP-

001/2022. AK ka shkelur edhe nenin 27/A pasi që shumë shërbime heterogjene i ka futur në të njëjtin Lot që e pamundësojnë implementimin e tyre në mënyrë efektive dhe efikase

Detajet e shkeljeve po i cekim në vazhdim:

Në dosjen e tenderit për projektin në fjalë janë vendosur disa kërkesa të cilat duken se nuk janë në përputhje me LPP-në dhe RRPP-001/2022 për natyrën e projektit, si dhe janë tejet diskriminuese krahasuar me natyrën e projektit dhe shërbimet që do të ofrohen. Në vazhdim po i renditim të gjitha pretendimet tona rreth kritereve kufizuese dhe jo proporcionale.1. Në dosjen e tenderit, lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale të OE është kërkuar që aplikuesit të dështojnë:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt përveq stafit të diplomuar – çertifikuar OE duhet të ketë min. 20 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e sherbimeve.** **a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip.i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga vet ai dhe kompania** **b) Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania**	**Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitat e kërkuara. Për stafin teknik - kontratat e punës ose parakontrata valide në kohëzgjatje të kontratës**
		Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT	**Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 7 të DT e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes, duke i bashkangjitur librezat e regjistrimit me validitet për të gjitha makinerit nga 1 – 12, ndersa nga 13-15 mund të ofrohen me dud ose faturë. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me kohëzgjatje të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës**

Sipas kërkesave të përcaktuara për këtë lloj stafi, shihet hapur se stafi i tillë është përcaktuar si kërkesë ekskluzivisht për një OE të caktuar sepse i njëjti posedon stafin e tillë e që për natyrën e projektit është janë plotësisht i panevojshëm. Në vend që të kërkohet inxhinieri i ndërtimtarisë ku shumica absolute e natyrës së shërbimeve i takojnë lëmisë së tij, AK kërkon inxhinier të bujqësisë dhe inxhinier të

komunikacionit që nuk kanë fare të bëjnë me shërbimet që kërkohen. Po ashtu edhe pajisjet e kërkuara i janë përshtatur ekskluzivisht OE që AK e favorizon të cilat janë me karakteristika teknike fikse dhe shumë kufizuese. Në vazhdim po i elaborojmë secilën veç e veç.Inxhinieri i komunikacionit i kërkuar në rastin konkret është i panevojshëm sepse komplet natyra e punës së këtij projekti bie tek inxhinieria e ndërtimtarisë.

Përpos kësaj Inxhinieri i Komunikacionit lëre që nuk e ka njohurinë e duhur për natyrën e shërbimeve që do të ofrohen, por përcaktimi i standardeve nga ana e tij gjatë implementimit të kontratës, konsiderohet tejkalim i kompetencave të këtij profesioni dhe përzierje në profesionin e ndërtimtarisë për të cilin nuk e ka përgatitjen shkollore adekuate. E lusim Ekspertin Shqyrtues që të krahasoj shërbimet të cilat do ofrohen në këtë kontratë me kompetencat e inxhinierit të komunikacionit. Nga ky krahasim do shihet se as edhe një shërbim i vetëm nuk lidhet me inxhinierinë e komunikacionit. Në rastin konkret kërkesa për një Inxhinier të Komunikacionit dhe mos përcaktimi i kërkesës që OE të kenë në përbërje Inxhinier të Ndërtimtarisë tregon se AK qëllimisht ka bërë kufizim të konkurrencës duke i diskriminuar jo vetëm OE por edhe vet profesionin e Inxhinierit të Ndërtimtarisë. Përcaktimin e standardeve për ofrim të shërbimeve lidhur me mirëmbajtjen e rrugëve e ka si përgjegjësi inxhinieria e ndërtimtarisë ndërsa ligjërisht inxhinieria e komunikacionit nuk mundet ta bëjë një gjë të tillë. Mirëmbajtja e rrugëve është detyrë që ekskluzivisht bie nën kompetencat e profesionit të inxhinierit të ndërtimtarisë andaj kërkesa për një inxhinier të Komunikacionit konsiderohet favorizim i OE përkatësisht diskriminim i të tjerëve.

Kërkesa tjetër për një Inxhinier të Diplomuar ose Bachelor të Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion në tërësi është kërkesë diskriminuese, jo obligative dhe e panevojshme si dhe në anën tjetër nuk është aspak e lidhur me natyrën e projektit, nuk është relevante dhe nuk lidhet fare me nevojat reale të ekzekutimit të kontratës. Nëse e shikojmë me vëmendje aneksin 1, përshkrimin e termeve të referencës dhe detyrat e shërbimeve të kontraktorit, shihet hapur se askund as që përmendet ndonjë bimë apo detyrë për mbrojtjen e bimëve apo drunjtëve. DMTH shihet hapur se kjo kërkesë i është përshtatur OE të caktuar pasi që i njëjti posedon në përbërjen e stafit të tijë një person me profesionin e tillë. Profesioni i inxhinierit të bujqësisë është plotësisht i panevojshëm sepse nuk është relevant dhe drejtpërdrejt i lidhur me natyrën e shërbimeve, andaj si i tillë duhet të largohet sepse konsiderojmë se është vendosur vetëm si një avantazh dhe favorizim për OE të caktuar si më lartë. Sikur këtij profesioni të i jepen detyra nga ana e AK-së që në fakt i takojnë profesionit të inxhinierisë së ndërtimtarisë, i bie se AK e ka shtyrë atë drejt tejkalimit të kompetencave që sipas nenit 414 të KPRK-së janë të dënueshme me 1-10 vite burgim. E themi hipotetikisht se nëse ndodh ndonjë aksident në rrugë si pasojë e përcaktimit të masave të sigurisë nga një Inxhinier i Bujqësisë apo nga një Inxhinier i komunikacionit (sasia e kripës ose pastrimi i rrugës) e që realisht nuk është as detyrë e as kompetencë ligjore e asnjërit nga ata, kush do të i bartë pasojat ligjore dhe juridike

Bazuar në krejt këtë, AK duhet detyrimisht të bëjë ndryshim të dosjes tenderit duke i larguar këto kërkesa kufizuese dhe jo relevante si dhe të përcaktoj vetëm kërkesa që lidhen drejtpërdrejt ma natyrën e lëndës përcaktuar tek aneksi 1 ashtu siç do ishte inxhinieri i ndërtimtarisë i cili është i vetmi profesion kompetent për përcaktim të standardeve të ofrimit të shërbimeve sipas kontratës.

AK nuk e ka respektuar nenin 27 të LPP-së as me rastin e përcaktimit të tabelave ku do të vendosen

çmimet. AK ka vendosur dy lista të çmimeve si të ndara që nuk janë të përfshira askund tek një rekapitullim i përbashkët dhe teknikisht është e pamundur të tenderohet me dy lista të çmimeve në një tender me vetëm një Lot dhe është e pakuptimet se si do përcaktohet çmimi total i tenderit. Përpos kësaj bashkë me listën e çmimeve janë ofruar edhe tre Excel-a të ndryshëm ku janë dhënë informata për rrugë të qytetit, rrugë të fshatrave dhe një rekapitullim i të fshatrave. Këto të dhëna ligjërisht duhet të ofrohen tek dosja e tenderit apo në tabela të ndara si Anekse të dosjes së tenderit e jo të futen tek lista e çmimeve. Është shumë e çuditshme se si KRPP – Departamenti i Monitorimit nuk e ka vërejtur një gabim të tillë. Përpos kësaj paramasa e qytetit është e ndarë nga paramasa e fshatrave dhe është e pamundur me i ngarkua të dyja bashkë pa e përcaktuar një çmim të vetëm për të dyja. Pra kjo formë e ndarjes dhe e paraqitjes së paramasave(listave të ndara të çmimeve) bie ndesh me mundësitë që i ofron prokurimi elektronik. Pra OE që duan të aplikojnë do ta kenë të pamundur të aplikojnë pa gabuar apo pa harruar ndonjë listë të çmimeve ashtu siç i ka komplikua qëllimisht AK-ja. Kjo lloj përzierjeje e të dhënave tek paramasat dhe vendet ku do të vendosen çmimet, është një lloj favoriteti për OE të cekur si më lartë për të cilin dyshohet se e ka ndihmuar ZPP-në në hartimin e dosjes së tenderit. Përzierja e tillë e të dhënave në të njëjtën kohë është diskriminuese për OE tjerë që nuk i kanë informatat e tilla nga brenda AK-së (siç i ka OE i cekur) e që do të jetë problem i madh për plotësimin e saktë të tyre.

219	4	Grumbullimi, ngarkimi dhe transporti i borës nga qyteti .	m³	1000		
220	5	Angazhimi i fuqisë punëtore në vendet ku nuk mund të intervenohet me makineri (gjatë sezonit veror mbledhja e mbeturinave, gjatë sezonit dimëror largimi i borës).	orë	2920		
221		**TOTALI**				
222						
223	**III**	**TABELA C (furnizime & shërbime tjera) 18 muaj**				
224						
225		**Përshkrimi**	**Njësia**	**Sasia**	**Çmimi**	**Totali**
226	1	Furnizimi me kripë	ton	225		
227	2	Ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja nëpër rrugë e kripës.	ton	225		
228	3	Furnizimi me rërë	m³	100		
229	4	Ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja nëpër rrugë e rërës.	m³	100		
230	5	Koha e kujdestarisë 24 orë (gjatë sezonit dimëror)	ditë	150		
231		**TOTALI**				
232						
233		**TABELA PËRMBLEDHËSE - REKAPITULLIMI -**				
234						
235		**Shërbimet dhe punet e kryera**				**Totali**
236	**I**	A - Fshirja dhe larja e rrugeve dhe trotuareve dhe pastrimi i borës 18 muaj				
237					**TOTALI**	
238		**Sherbime të veçanta**				
239	**II**	B - Sherbime te veqanta 18 muaj				
240	**III**	C - Furnizime & shërbime tjera 18 muaj				
241					**TOTALI**	
242						
243					**TOTALI gjithsej**	
244						
245						
246		Vërejtje:				
247		1.Çmimi llogaritet në bazë të sipërfaqeve konkrete (m² të pastruara), brenda 24 orëve, edhe nëse është e nevojshme të intervenohet disa herë brenda ditës.				
248		2.Pozicionet B & C llogariten në bazë të sasisë dhe shërbimeve të kryera brenda 18 muajve.				
249						
250		3.Hedhja e kripës me rërë (në raport 2:1) bëhet në ato sipërfaqe ku ka akull dhe ngrica në temperatura nën zero .				
251		4.Në disa fshatra të cekura, vlejnë vetëm rrugët që janë në kompetencë komunale kurse rrugët regjionale janë përgjegjësi e MI				
252		5. Në rast të mos pastrimit të ndonjë rruge nga ana e OE, aksidentet eventuale që mund të ndodhin pasojat e më tutjeshme do ti bartë vet OE.				
253						

Paramasa e qytetit | Specifikimi i rrugëve qytetit | Paramasa e fshatrave | Rikapitullim i fshatrave | Specifikim i rrug. të fshatrave

Ndërsa një paramasë tjetër është vetëm për MIRËMBAJTJA VERORE DIMËRORE E ZONAVE RURALE. Ja si duket kjo tabelë:

MIRËMBAJTJA VERORE DIMËRORE E ZONAVE RURALE

A: Mirëmbajtja verore:

Mirembajtje verore e rrugeve te fshatrave - Sherbime te veqanta 18 muaj

		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
I	**Punët e shërbimeve**				
1	Pastrimi dhe largimi i pengesave nga brezi anesor i rrugëve: gurë, rërë, dheu, drunjë, sipas kërkesës së OM.	km	100.00		
2	Pastrimi, kositja, krasitja e pjeseve anesore te rrugeve sipas kërkesës së OM.	km	100.00		
3	Pastrimi, kositja, krasitja e hapesirave te gjelbra publike sipas kerkeses se OM.	m²	10,000.00		
4	Intervenimi në periferi të qytetit dhe fshatra : pastrim fshirje larje sipasa kërkesës së OM.	m²	25,000.00		
5	Grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave inerte nga pikat e egra në fshatra, sipas nevojës.	m²	100.00		
6	Ngarkimi,transportimi dhe deponimi i dheut të shembur nga skarpatet e rrugës.Në pozicion përfshihet edhe pastrimi i rrugës pas largimit të dheut.	m²	300.00		
				TOTALI	

B: Mirëmbajtja dimërore:

Pastrimi i borës, akullit, kryposja dhe pastrime tjera, në këtë sezonë.

		Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
I	**Punët e shërbimeve**				
1	Largimi i borës dhe akullit në rrugët e fshatrave	m²	2,496,315.94		
				TOTALI	

C: Furnizime & shërbime tjera 18 muaj :

Furnizimi me kripë , kujdestaria dhe intervenimi në zonat e thella malore gjatë sezonës dimërore.

	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
1	Furnizimi me kripë	ton	400.00		
2	Ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja nëpër rrugë e kripës.	ton	400.00		
3	Furnizimi me rërë	m³	200.00		
4	Ngarkimi, transportimi dhe shpërndarja nëpër rrugë e rërës.	m³	200.00		
5	Koha e kujdestarisë 24 orë (gjatë sezonit dimëror)	ditë	300.00		
6	Intervenimi me makineri të rëndë (frezë bore, ngarkues) në zonat e thella malore në rastet kur nuk mund të intervenohet me makineri tjera .	orë	320.00		
	TOTALI				

	RIKAPITULLIM	
A:	**Mirëmbajtja verore:**	
B:	**Mirëmbajtja dimërore:**	
C:	**Furnizime & shërbime tjera 18 muaj :**	
		TOTALI

Paramasa e qytetit | Specifikimi i rrugëve qytetit | **Paramasa e fshatrave** | Rikapitullim i fshatrave | Specifikim i rrug. të fshatrave

Me që në E- Prokurim të jepet mundësia me ngarkua vetëm një paramasë dhe me vendos vetëm një çmim, atëherë vendosja në sistem e dy paramasave që nuk lidhen fare njëra me tjetrën konsiderohet tentim për mashtrim të OE-ve duke i shtyrë ata qëllimisht në ndonjë gabim eventual në mënyrë që të i eliminohen nga AK me lehtësi. AK në kundërshtim të plotë me nenin 27/A të LPP-së i ka ngatërruar qëllimisht llojet e shërbimeve dhe me këtë verim ka shkelur plotësisht dispozitën e cekur pasi që kjo dispozitë e obligon AK-në që shërbimet heterogjene të i ndaj në Lot-e. Po përshkruaj vetëm një pjesë: pastrimi, kositja, krasitja e hapësirave te gjelbra publike, grumbullimi, transporti dhe deponimi i mbeturinave inerte nga pikat e egra nëpër qytet dhe periferi, pastrimi i rrugëve nga bora në sezonin e dimrit, largimi i borës nga sheshi i qytetit, larja e rrugëve të qytetit, debllokimi i kanalizimeve e shumë shërbime tjera janë shërbime komplet të ndryshme/heterogjene që në asnjë logjikë të shëndosh nuk munden me qenë në të njëjtin Lot. Stafi i kërkuar, pajisjet e kërkuara si dhe sasia e tyre në numër, e pamundësojnë një mirëmbajtje të rrugëve të qytetit dhe fshatrave në të njëjtën kohë. Ne e dimë që kur bie borë, ajo bie në të njëjtën kohë në fshatra dhe qytet. A thua

sa e ka kalkulua AK kohën e reagimit për pastrimin e rrugëve kur me 5 kamion dhe me 4 traktorë synon të mirëmbaj rrugët e komplet qytetit, sheshin e qytetit dhe rrugët e komplet fshatrave të komunës së Podujevës që shprehur në KM gjatësi arrin deri afërsisht 600 KM. Sipas kësaj matematike atyre në fshatrat e thella do iu vjen radha diku pas 6 dite që të iu pastrohet rruga nga bora. Pra AK duhet të vendos kritere, kërkesa dhe të ndaj tenderin ë Lot-e me qëllim që shërbimi i pastrimit dhe mirëmbajtjes së rrugëve të realizohet brenda normave ligjore të reagimit sidomos kur kemi të bëjmë me pastrim të rrugëve nga bora apo nga ndonjë bllokim tjetër i pa parashikuar. Pra nisur nga kjo AK duhet menjëherë të veproj duke e unifikuar tabelën e shërbimeve në të vetme për secilin lloj të shërbimeve, të ndaj tenderin në së paku tre ose katër lot-e sepse kjo formë e hartuar e dosjes së tenderit do ta shtyjë AK-në drejt dështimit të qëllimshëm të procedurës së prokurimit përkatësisht edhe kontratës nëse veç arrijnë ta nënshkruajnë atë e ku sipas nenit 1 të LPP-së është rreptësishtë e ndaluar. AK gjithashtu ka kërkuar një listë të pajisjeve që duhet ti posedojnë OE e cila duket kështu:

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Numri identifikues i paisjeve
1	Kamion cisterna special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve të jetë me vëllim mbi 7000 Litra. (Kamion cisterna duhet të ketë mekanizmin për larje nga ana e përparme dhe nga ana e prapme me punëtorë)	3	
2	Kamion special për pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës mbi 5 ton.	3	
3	Kamion special për pastrimin e rrugëve nga bora dhe hedhjen e kripës për rrugë të ngushta max 5 ton me peshë bartëse.	2	
4	Kamion (cisternë) special me mekanizim komplet (thithje, de bllokim) për pastrim dhe de bllokimin e ujëmbledhësve tëkanalizimit atmosferik të jetë me vëllim mbi 10000 litra	1	
5	Auto fshese speciale deri në 5 ton për fshirjen e rrugëve dhe trotuareve të qytetit.	1	
6	Auto fshese speciale deri në 3 ton për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit.	1	
7	Kamion special me paisje mulqer për kositjen e brezit tërrugëve.	1	

8	Lugë ngarkuese deri në 7 ton për ngarkim mbeturinave dhe kirpës.	2	
9	Auto shportë për krasitje të drunjëve.	1	
10	Paisje sinjalizuese elektronike për paralajmrim të punimeve në komunikacion (duke mos rrezikuar pjesmarrësit ne trafik) gjysemrimorkio.	1	
11	Traktor special 4x4 për pastrim bore deri ne 2 tonë	3	
12	Traktor me kosë për kositje të hapësirave gjelbëruese derine 1.5 tonë.	1	
13	Makina kositëse për hapësira të vogla.	3	
14	Makinë kositëse krahu (trimer) përgjatë rrugëve.	4	
15	Makinë për bluarjen e degëve pas krasitjes.	1	

Pajisjet e hijezuara me të verdhë janë kërkuar me kufizime të shumta dhe janë të pa nevojshme të cilat gjithashtu janë edhe të ekzagjeruar dhe jashtë kufijve maksimal ku disa nga ato janë plotësisht të panevojshme për volumin e kontratës. Qëllimi i AK-së gjatë vendosjes së këtyre kërkesave është kryesisht për të siguruar avantazh karshi OE tjetër me qëllim që të përcaktohet dhe lehtësohet përzgjedhja e fituesit. Një kapacitet të tillë të makinerisë nuk e kërkon as Ministria e Infrastrukturës e cila realizon kontrata shumë më komplekse dhe me vlera deri në 30,000,000.00 nga lëmia e mirëmbajtjes së rrugëve nacionale dhe regjionale duke mos përjashtuar edhe Autostradën e cila është rruga më primare ne Republikën e Kosovës.

Për deri sa pagesa e larjes së rrugës do të paguhet me metër katrorë, pse qenka me rendësi përcaktimi i litrazhës fikse të cisternës. Me që pagesa bëhet për sipërfaqe atëherë pak ka rëndësi se OE a e kryen punën me dy cisterne me nga 5000 litra apo e kryen punën me një cisterne me 10000 litra. E njëjta vlen edhe për traktorin ku kufizimi në 4x4 dhe kufizimi në 1.5 ton është plotësisht i pa arsyeshëm. Është e çuditshme që për pastrim të rrugëve nga bora i ka kërkuar vetëm 5 kamion për deri sa ka për ti pastruar pothuajse në të njëjtën kohë të gjitha rrugët e fshatrave dhe të qytetit. Duke marrë për bazë që komuna e Podujevës është e dyta vend për nga sipërfaqja, sasia e tillë e kamionëve është tepër e vogël.

Pra sipas kësaj po shihet hapur se edhe pajisjet dhe lloji i pajisjeve të kërkuara i është përshtatur komplet OE të cekur më lartë e cila për OE të tjerë konsiderohet kufizim i pastër i konkurrencës. Nisur nga kjo konsiderojmë se AK duhet menjëherë të ndryshoj këto kërkesa dhe të vendos kërkesa relevante që i përshtaten plotësisht natyrës dhe volumit të shërbimeve që parashihen në kontratën e tillë.

Krejt këto kërkesa dhe kritere bien komplet në kundërshtim me dispozitat ligjor të cilat e detyrojnë AK-në që përpos vendosjes së kërkesave relevante dhe sipas natyrës së prokurimit, të i kushtojnë rëndësi edhe promovimit të kompanive fillestare që posedojnë staf, pajisje dhe makineri të mjaftueshme për natyrën e projektit. Kërkesa për makinën e bluarjes së degëve pas

krasitjes është e çuditshme kur shihet se sipas termeve të referencës, OE e ka për detyrë krasitjen e tyre dhe largimin deri në deponoi. Tash a i bluan apo i dërgon ashtu pa i bluar është çështje teknike që OE vendos vet si ta bëjë. Kjo kërkesë e favorizon OE te cekur më lart dhe i diskriminon të tjerët sidomos kur nga përshkrimi i shërbimeve, askund nuk ceket se çka do

bëhet me degët e krasitura. Nisur nga kjo, arsyetimi i AK-së për refuzim të pretendimeve tona, përpos që nuk është i mbështetur me asnjë fakt apo argumentim real, shpikja e asaj që kinse materiali i përfituar nga bluarja do përdoret për dekorim të parqeve është edhe qesharak. Tani shtrohet pyetja, kjo procedurë e prokurimit është për mirëmbajtje të rrugëve dhe trotuareve apo për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e parqeve? Po ashtu edhe arsyetimi për gjoja peshën e mjeteve të cilave u frikohet AK se do ta dëmtojnë trotuarin është e pa arsyeshme dhe vetëm si shkas pasi që dihet shumë mirë që pesha e detyruar mbajtëse e trotuareve ligjërisht bëhet përafërt sikur se e rrugës së asfaltuar. Kjo bëhet për faktin se në raste urgjente sidomos kur kemi të bëjmë me shuarje të zjarreve të ndryshme, autocisternat për të depërtuar në zonat e zjarrit lëre që shkelin trotuaret po shkelin ndonjëherë edhe parqet e gjelbëruara. Pra arsyetimi i tillë del të jetë jo profesional dhe i pa bazuar në ligjin e ndërtimtarisë. Arsyetimi tjetër për traktorin 4x4 po ashtu është i pakuptimët sepse në rastin e tillë pastrimi i sheshit mundet të bëhet pa problem edhe me traktor që janë 4x2 të dedikuar për punët e tilla.

Ne nuk e kuptojmë fare se si mundet që dy natyra kaq të ndryshme të jenë në një lot të përbashkët. "AK-së i ka mbetur pa përcaktuar vetëm edhe ndonjë kërkesë për ngjyrosjen e parmakëve të urave apo pastrimin e grafiteve nga muret e shkollave".

Nisur nga krejt këto që theksuam më lartë shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 27, dhe 27/A të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe në përgjithësi gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit deri më tani.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 51 të LPP gjatë përcaktimit të kritereve të përzgjedhjes sepse siç e sqaruam në pretendimin e mësipërm ka përcaktuar kritere dhe kërkesa shumë jo relevante dhe shumë jo proporcionale në krahasim me madhësinë dhe natyrën e tenderit që e ka iniciuar. Ja si e përshkruan pika 3 e këtij neni këtë obligimin e AK-së gjatë hartimit të kritereve në projekte të tilla:

krasitjen e tyre dhe largimin deri në deponoi. Tash a i bluan apo i dërgon ashtu pa i bluar është çështje teknike që OE vendos vet si ta bëjë. Kjo kërkesë e favorizon OE te cekur më lart dhe i diskriminon të tjerët sidomos kur nga përshkrimi i shërbimeve, askund nuk ceket se çka do bëhet me degët e krasitura. Nisur nga kjo, arsyetimi i AK-së për refuzim të pretendimeve tona, përpos që nuk është i mbështetur me asnjë fakt apo argumentim real, shpikja e asaj që kinse materiali i përfituar nga bluarja do përdoret për dekorim të parqeve është edhe qesharak. Tani shtrohet pyetja, kjo procedurë e prokurimit është për mirëmbajtje të rrugëve dhe trotuareve apo për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e parqeve? Po ashtu edhe arsyetimi për gjoja peshën e mjeteve të cilave u frikohet AK se do ta dëmtojnë trotuarin është e pa arsyeshme dhe vetëm si shkas pasi që dihet shumë mirë që pesha e detyruar mbajtëse e trotuareve ligjërisht bëhet përafërt sikur se e rrugës së asfaltuar. Kjo bëhet për faktin se në raste urgjente sidomos

kur kemi të bëjmë me shuarje të zjarreve të ndryshme, autocisternat për të depërtuar në zonat e zjarrit lëre që shkelin trotuaret po shkelin ndonjëherë edhe parqet e gjelbëruara. Pra arsyetimi i tillë del të jetë jo profesional dhe i pa bazuar në ligjin e ndërtimtarisë. Arsyetimi tjetër për traktorin 4x4 po ashtu është i pakuptimët sepse në rastin e tillë pastrimi i sheshit mundet të bëhet pa problem edhe me traktor që janë 4x2 të dedikuar për punët e tilla.

Ne nuk e kuptojmë fare se si mundet që dy natyra kaq të ndryshme të jenë në një lot të përbashkët. "AK-së i ka mbetur pa përcaktuar vetëm edhe ndonjë kërkesë për ngjyrosjen e parmakëve të urave apo pastrimin e grafiteve nga muret e shkollave".

Nisur nga krejt këto që theksuam më lartë shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 27, dhe 27/A të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP-001/2022 gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe në përgjithësi gjatë administrimit me këtë procedurë të prokurimit deri më tani.

Pretendimi 3: AK ka shkelur nenin 51 të LPP gjatë përcaktimit të kritereve të përzgjedhjes sepse siç e sqaruam në pretendimin e mësipërm ka përcaktuar kritere dhe kërkesa shumë jo relevante dhe shumë jo proporcionale në krahasim me madhësinë dhe natyrën e tenderit që e ka iniciuar. Ja si e përshkruan pika 3 e këtij neni këtë obligimin e AK-së gjatë hartimit të kritereve në projekte të tilla:

> Të gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Bazuar në këtë dhe në sqarimet e mësipërme si dhe krahasimin e tyre me dosjen e tenderit si dhe listën e çmimeve, shihet se AK e ka shkelur plotësisht nenin 51.3 të LPP-së gjatë hartimit të kësaj dosjeje të tenderit dhe gjatë përcaktimit të kërkesave të vendosura në të.

Pretendimi 4: AK ka shkelur gjithashtu nenin 69 të LPP-së me rastin e përcaktimit të kërkesave lidhur me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi që ka kërkuar dëshmi të cilat përpos që janë në kundërshtim me nenet e cekura më lartë, nuk janë fare proporcionale me natyrën e projektit që parashihet të realizohet përmes kësaj procedure. Sqarimet se në cilat pika janë shkelur nenet në fjalë janë dhënë tek pretendimi 1 dhe 2 andaj kërkojmë që eksperti shqyrtues përkatësisht paneli shqyrtues i OSHP-së ta detyrojnë AK-në që ato kërkesa të përmirësohen dhe të sillen brenda normave ligjore të përcaktuar me dispozitat adekuate ligjore. Në bazë të kësaj konstatojmë se AK nuk ka vepruar fare në përputhje me nenin 69 të LPP ku si rrjedhojë, gjatë hartimit të dosjes së tenderit përkatësisht ftesës për kualifikim edhe i ka shkelur ato.

Bazuar në krejt këtë që theksuam më lart kërkojmë nga OSHP-së që të merr:

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e OE *"VIA EGNATIA SH.P.K."* lidhur me tenderin *"Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve".*

ANULOHET njoftimi për kontratë i *AK - KOMUNA E PODUJEVËS.* AK të angazhohet seriozisht dhe të eliminoj kërkesat kufizuese nga dosja e tenderit, të vendos kërkesa proporcionale me projektin dhe të

rregulloj listën e çmimeve. Gjithashtu të rishikohen të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit duke i harmonizuar ato me LPP-në dhe RRPP-001/2022 si dhe duke ia përshtatur natyrës së projektit, procedurës si dhe shpenzimit efikas dhe efektiv të parasë publike.

Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesën e deponuar ne OSHP, janë të njëjta.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	**Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit fiskale ka qenë prej jo më pak se 1,200,000.00 Euro**	**Deklaratat e dorëzuara ne Administratën Tatimore te Kosovës apo Kopjet e raporteve financiare dhe raporteve te menaxhimit te certifikuara nga një firme e njohur e licencuar për kontrollim apo një auditor i licencuar i pavarur**
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme në vlerë minimale prej 900,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Në rast të formimit të grupit (konsorciumit), udhëheqësi i grupit duhet të ketë së paku 51% të shumës së kërkuar në punë të ngjajshme të realizuara në tre vitet e fundit**	**Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të punëve.**
		OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt përveq stafit të diplomuar – çertifikuar OE duhet të ketë min. 20 punëtorë të mjaftueshëm për kryerjen e sherbimeve. **a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip.i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga vet ai dhe kompania b) Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të**	**Lista e stafit profesional së bashku me diplomat, CV-të, kontratat e punës ose marrëveshja për bashkëpunim në këtë projekt, dëshmitë mbi përvojën e punës. Për ti plotësuar kërkesat duhet të ofrohen edhe këto dëshmi së paku një letër referencë nga punëdhënësi ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme si dhe vendimet e nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania për caktimin në pozitat e kërkuara. Për stafin teknik - kontratat e punës**

		ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania	**ose parakontrata valide në kohëzgjatje të kontratës**
		Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT	**Duhet të ofrohet një listë e pajisjeve sipas Aneksit 7 të DT e cila duhet të jetë e noterizuar nga noteri me procedurë en-minutes, duke i bashkangjitur librezat e regjistrimit me validitet për të gjitha makinerit nga 1 – 12, ndersa nga 13-15 mund të ofrohen me dud ose faturë. Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen, marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me kohëzgjatje të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët, duhet te jete e noterizuar dhe nuk mund të jetë më herët se data e publikimit të njoftimit të kontratës**
		Licenca e MMPH për administrimin e mbeturinave	**Licenca e lëshuar nga MMPH për natyrën e kontratës - valide**
		Kontrata e KMDK për deponimin e mberurinave	**Kontratë me KMDK për hedhjen e mbeturinave - valide**
		Plani i veprimit për kryerjen e shërbimeve sipas specifikacionit teknik të DT	**Plani duhet të jetë i përgatitur në mënyrë sa më të detajuar, i nënshkruar dhe vulosur**
		OE është i obliguar që vendparkimin për makinerinë e sezonit verorë dhe dimëror ta ketë në territorin e Komunës së Podujevës - jo më larg se 10 km nga qyteti.	**Dëshmi fleta poseduese ose marrëveshja për marrje në shfrytëzim, marrëveshja duhet të jetë e noterizuar**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

N/A

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **VIA EGNATIA SH.P.K.**

Sqarim: OE ankues ne pretendimin 1 ka pretenduar se AK-ja ka bere shkelje te neneve 7, 27, 51 dhe 69 te LPP-se por nuk i ka elaboruar pretendimet e tij dhe shkeljet e supozuara prandaj shqyrtimi i pretendimeve do te behet nga pretendimi 2.

Përgjigje në Pretendimin Nr.1 dhe 2:

Lidhur me pretendimet e OE ankues për vendosjen e kritereve kufizuese dhe mos vendosjen e disa kërkesave te domosdoshme për natyrën e projektit si dhe pretendimet se AK ka shkelur nenin 27 të LPP-së dhe nenin 17 të RRPP 001/2022 eksperti shqyrtues ka marrë për bazë të shqyrtimit RRPP 001/2023, LPP-në si dhe të gjitha dokumentet e ngarkuara ne eprokurim dhe praktikat e mëparshme të AK-ve në Republikën e Kosovës për aktivitetete te ngjashme te Prokurimit.

1. Lidhur me pretendimin e OE ankues qe ka te beje me shkeljet e LPP-se Nenit 27A **Ndarja e kontratave në Lote** eksperti shqyrtues sqaron se **sipas Nenit 9 te LPP-se Përcaktimiinevojaveqë duhetpërmbushur –** ZKA i AK-se duhet te beje një vlerësim formal te nevojave qe duhet përmbushur,

Me këtëvlerësimpërcaktohen(i)lloji dhepërmasatesaktatë nevojavetëveçantatë autoritetit kontraktuesqëprokurimi ipropozuarparasheht'iplotësojë;(ii)vleraeparashikuar,llojii propozuardhekushtetpërmbajtjesoretë kontratëspublikeqë dotë jenëlëndëeprokurimit të planifikuar;(iii)specifikimet epropozuara funksionaletë secilitobjektqëdotëpërfshihetnganjë kontratëetillë;

Nësepasvlerësimittë nevojave,ZKAvendossevlerësimiinevojaveearsyeton ushtrimine aktivitetittëprokurimit, ZKAidërgonnjëkopjetëkëtijvlerësimiZKFtëautoritetitkontraktues.

Sidëshmise autoritetikontraktues është pajtuar meparagrafët1. deri 4. tëkëtij neni,ZKAdhe ZKFdo tëpërgatisindhenënshkruajnënjë "DeklaratëtëNevojave dhe Vendosmërisëpër DisponueshmërinëeFondeve".

AK-ja sipas kërkesave te LPP-se ka ngarkuar ne eprokurim edhe deklaratën e nevojave dhe disponueshmerisë se fondeve dhe e njëjta është aprovuar ne përputhje me kërkesat e LPP-se.

Eksperti shqyrtues vlerëson se sipas LPP-se dhe RRPP **13.2 Në rast të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene ose heterogjene, kontrata mund të ndahet në lote (pjesë)** " Pra është ne diskrecion te AK-se i cili mund te beje përcaktimin e nevojave ne përputhje me nenin 9 dhe si rrjedhoje pretendimi i OE ankues se është dashur te ndahen ne LOT-e**është i paqëndrueshëm**.

2. Lidhur me pjesën e pretendimit ku OE ankues e konteston kërkesën a) Menaxher i projektit - Inxhinier i dip. i Komunikacionit - minimumi 5 vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku 1(një) projekt nga lëmia e kërkuar. Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga vet ai dhe kompania

Përmbajtja e dosjes së tenderit Aneksi 1 **Konceptetthemeloretëkontratavetëmirëmbajtjes**

Mirëmbajtjaerrjetitrrugorpërfshindetyratemirëmbajtjes**rutinë**dhe**periodike**.Mirëmbajtjarutinëkonsist onnëdetyraqëjanëtënevojshmepërtëmirëmbajturfunksionimin e rrugës **(siç janë, fshirja, larja,prerjaeshkurreve,etj.).**

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues se është dashur te kërkohet Inxh. i ndërtimtarisë është sqaruar edhe me lartë sipas nenit 9 te LPP-së dhe nga specifikimi teknik dhe përshkrimi i teknik ne aneksin 1 të dosjes së tenderit është e qartë subjekti i tenderit dhe sipas vlerësimit te ekspertit AK-ja nuk ka vendosur kritere diskriminuese për këtë pike sepse kërkesa Inxh. i Komunikacionit është kërkesë që mund ta plotësojë pjesa dërmuese e OE, në treg të punës ka mjaftueshëm të diplomuar në drejtimin e kërkuar dhe sipas specifikimit teknik Aneksi 1 është kërkuar Plani i Menaxhimit të Trafikut që përfshin kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me trafikun. Poashtu kërkesa për dëshmi te menaxhimit të së paku një projekti është kërkese minimale qe është në përputhje me nenin 9 te LPP-se, Dosjen e tenderit, Specifikimin teknik Aneksi 1 (faqe 25, 26 te DT).

Poashtu eksperti shqyrtues vlerëson se OE ankues gjatë kërkesës për sqarim te AK-ja me datën 13.06.2023 në këtë pikë ka deklaruar **"Pse nuk është i mundur edhe inxhinier i ndërtimtarisë"** që është pajtuar me kërkesën dhe është ne kundërshtim me atë çka është pretenduar në ankesën e dorëzuar ne OSHP.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi për këtë pjese **nuk është i qëndrueshëm.**

3. Lidhur me pjesën e pretendimit që ka të bëjë me kërkesën *"Një inxhinier i diplomuar ose bachelor i Bujqësisë (drejtimi mbrojtja e bimëve) me së paku 5 vite përvojë pune në profesion. Të ketë së 1 referenca të udhëhequr të natyrës së njëjtë). Të caktohet me shkresë dhe të jetë i nënshkruar nga inxhinieri dhe kompania"*

Përmbajtja e dosjes se tenderit Aneksi 1 **Konceptetthemeloretëkontratavetëmirëmbajtjes**

Mirëmbajtjaerrjetitrrugorpërfshindetyratemirëmbajtjes**rutinë**dhe**periodike**.Mirëmbajtjarutinëkonsist onnëdetyraqëjanëtënevojshmepërtëmirëmbajturfunksionimin e rrugës **(siç janë, fshirja, larja,prerjaeshkurreve,etj.).**

Specifikimet teknike te bashkangjitura ne DT janë për mirëmbajtje dimërore dhe ne asnjë rast nuk përshkruajnë kërkesa specifike për mirëmbajtje verore.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja nuk ka mundur ta arsyetojë në mënyrë objektive kërkesën për

Inxhinier te Bujqësisë drejtimi (Mbrojtja e Bimëve) derisa ne specifikim teknik nuk ka asnjë përshkrim për këtë kërkesë përveç një fjalie në paramasë dhe parallogari.

Prandaj bazuar ne specifikimin teknik te DT specifikimin teknik, përshkrimin e shërbimeve, paramasë dhe parallogarinë Eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesa 9.1 & 9.2 - b) nuk është ne përputhje me RRPP Neni 17. Paragrafi 17 si dhe neni 25 paragrafi 6, rrjedhimisht vlerëson se pretendimi për këtë pjesë **është i qëndrueshëm.**

4. Sa i përket pjesës së pretendimit te OE ankues që ka të bëjë me listën e çmimeve eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja në sistemin e eprokurimit ka ngarkuar paramasën e cila ka dy faqe (sheet) të cilat janë të dedikuara për ofertën financiare derisa pjesa tjetër është emërtime të rrugëve. Lista e çmimeve është pjesë e dosjes se tenderit dhe rrjedhimisht edhe pjesë e kontratës sipas nenit 4 të draft kontratës pjesë e dosjes së tenderit. OE-të duhet të jenë të vëmendshëm kur e plotësojnë listën e çmimeve. Pretendimi i OE se është e pamundur që të tenderohet me dy lista nuk qëndron sepse sistemi i eprokurimit lejon të ngarkohet paramasa me disa faqe ashtu si është e ngarkuar edhe nga AK-ja por që OE-te pjesë e aktivitetit të prokurimit kanë mundësinë edhe të plotësimit te ofertës dhe të skenimit në (pdf) të cilën shumica e OE edhe e bëjnë.

Për me tepër OE që ofertojnë duhet ta plotësojnë edhe formularin e dorëzimit te tenderit e cila përfshin çmimin e përgjithshëm dhe lexohet gjatë hapjes.

AK-ja në paramasen e qytetit dhe të fshatrave ka përshkruar tri tabela te emërtuara si (A, B,C) te cilat janë përmbledhur ne total. Fakti se ne paramasë kanë qasje të gjithë OE-të njëjtë e vërteton se nuk ka të bëjë me diskriminim. AK-ja në mënyrë qe ta lehtësojë ofertimin për OE të interesuar të marrin pjesë në këtë aktivitet të prokurimit mund ta vendosin edhe një faqe (Excel sheet) si rikapitullim te dy cmimoreve (qytetit dhe fshatrave).

Prandaj bazuar ne sqarimet e dhëna eksperti shqyrtues në këtë pikë konsideron se pretendimi **është pjesërisht i bazuar.**

5. Lidhur me pretendimet e OE ankues ne lidhje me Aneksin 7. tabelën e pajisjeve qe duhet te posedojnë OE pika 1

Kamion cisterna special me mekanizëm komplet për larje të rrugëve të jetë me vëllim mbi 7000 Litra. (Kamion cisterna duhet të ketë mekanizmin për larje nga ana e përparme dhe nga ana e prapme me punëtorë, dhe

kërkesën nr. 4 te Aneksit 7 "Kamion (cisternë) special me mekanizim komplet (thithje, debllokim) për pastrim dhe de bllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik të jetë me vëllim mbi 10000 litra".

Eksperti shqyrtues vlerëson se përshkrimi i punëve ne dosje të tenderit nuk e përcakton ndonjë kufizim kohor apo ndonjë kërkesë specifike brenda te cilit duhet te behet pastrimi qe do te arsyetonte një kërkesë me specifika te tilla. Poashtu kërkesa qe kamioni të ketë mekanizëm për larje nga ana e përparme dhe nga ana e pasme me punëtorë nuk ndikon ne cilësinë apo shpejtësinë e kryerjes se shërbimit. Për me tepër

shërbimi faturohet ne bazë të metrave katror të sipërfaqes, prandaj kufizimi i mekanizimit dhe vëllimit të rezervarit në piken 1 dhe 4 si dhe nuk është ne përputhje me Nenin 51 te LPP-se paragrafi 4 (ii) Nenin 69 paragrafin 1 te LPP-se si dhe nenin 8.4 te UOPP.

8.4 Gjatë përcaktimit të kërkesave minimale për kualifikim, AK do ti kushtoj rëndësi të veçantë zhvillimit të OE dhe do të formuloj kërkesat minimale të kualifikimit në mënyrë që nuk përjashton OE të themeluar rishtazi të cilët posedojnë aftësi të arsyeshme dhe të mjaftueshme ekonomike, financiare dhe/ose teknike. "Të arsyeshme dhe të mjaftueshme" do të nënkuptoj në lidhje me:

i. vlerën e parashikuar të kontratës, dhe

ii. përdorim të drejtë të fondeve publike.

e) Kërkesa minimale për Veglat, hapësirat ose pajisjet teknike	e. Një deklaratë të veglave, hapësirave ose pajisjeve teknike në dispozicion të tenderuesi që ofron shërbimet

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi në këtë pikë **është i qëndrueshëm.**

1. Pretendimi ne lidhje me kërkesën nr. 5, Auto fshese speciale deri në 5 ton për fshirjen e rrugëve dhe trotuareve të qytetit. 6, Auto fshese speciale deri në 3 ton për fshirjen e rrugëve, trotuareve dhe shesheve të qytetit 9. Auto shportë për krasitje të drunjëve 12. Traktor me kosë për kositje të hapësirave gjelbëruese deri ne 1.5 tonë 15. Makinë për bluarjen e degëve pas krasitjes.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja ne këtë pikë ka kërkuar pajisje **"deri në"** që nënkuptohet se OE-të mund të ofrojnë pajisje me peshë më të vogël, pra ju është ofruar mundësia më e gjërë e ofrimit te llojeve te pajisjes.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se kërkesat si më larte janë ne përputhje me RRPP dhe pretendimi i OE **nuk është i qëndrueshëm.**

Ndersa sa i perket kërkesës 11. Traktor special 4x4 për pastrim bore deri ne 2 tonë eksperti shqyrtues vlereson se AK-ja nuk ka vendosur kerkesa ne perputhje me RRPP neni 8.4 pika e) sepse e ka kufrizuar konkurrencen.

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se kufizimi i pajisjes si me larte nuk është ne përputhje me RRPP dhe pretendimi i OE **është i qëndrueshëm.**

<u>Përgjigje në Pretendimin Nr. 3:</u>

Eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimit te OE ankues në këtë pikë i është dhënë përgjigje ne pretendimin 1 dhe 2.

<u>Përgjigje në Pretendimin Nr. 4:</u>

Lidhur me pretendimin ankimor te OE ankues ne këtë pikë eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë hartimit te dosjes se tenderit kërkesat teknike profesionale nuk e ka respektuar ne tërësi nenin 51 dhe 69 te LPP-së si dhe nenin 8 te RRPP 001/2022.

Eksperti shqyrtues gjate analizimit te dosjes se tenderit poashtu ka vërejtur se te *"Plani i Menaxhimit te shëndetit dhe sigurisë" AK-ja i referohet "Ligjeve te Shqipërisë".*

Poashtu ne specifikimi teknik te Raportimi AK-ja i referohet *"BazatemirëmbajtjesdotëjenënëkontakttëpërhershëmmestacionetmeteorologjiketëShqipërisë"*

Prandaj eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi ankimor për këtë pikë i është dhënë përgjigje edhe në pretendimin 1 dhe 2 dhe **është i bazuar.**

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, të korrigjohet dosja e tenderit në përputhje me nenin 51 të LPP-se dhe nenin 54 te RRPP 001/2022.

Të zgjatet afati sipas kërkesave të LPP-së.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA E PODUJEVËS**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **VIA EGNATIA SH.P.K.**

Burim Zeka